REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**MINISTRI**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ____/____/2018

**UDHËZIM**

**Nr. 7642 Datë 5/7/2018**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE RREGULLAVE TË PËRGATITJES SË DOKUMENTIT PËR LIRIMIN ME KUSHT TË TË MITURIT TË DËNUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 133 pika 9 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

**U DH Ë Z O J:**

1. Miratimin e formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirim me kusht të të miturit të dënuar dhe vlerësimin e rrezikut dhe nevojave familjare dhe shoqërore/mjedisore të tij referuar modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ngarkohet struktura përgjegjesë për çështjet e drejtësisë penale për të miturit, pranë Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Etilda Gjonaj (Saliu)**

## DOKUMENTI I LIRIMIT ME KUSHT TË TË MITURIT TË DËNUAR

### I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

**I.1. I mituri i dënuar:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Emri: | |
| 2. | Atësia: | |
| 3. | Mbiemri: | |
| 4. | Datëlindja: | |
| 5. | Vendlindja: | |
| 6. | Adresa e banimit: | |
| 4. | Gjinia: | M ☐ F ☐ |

**I.2. Të dhënat e familjarit/kujdestarit ligjor:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Emri: | |
| 2. | Atësia: | |
| 3. | Mbiemri: | |
| 4. | Cilësia e përfaqësimit: | |

**I.3. Të dhënat e vendimit gjyqësor dhe dënimit të të miturit:**

| | |
|---|---|
| 1. | Numri dhe data e vendimit gjyqësor të dënimit: |
| 2. | Gjykata/seksioni që ka dhënë vendimin e dënimit: |

... kohëzgjatja e dënimit të dhënë nga gjykata (vite/muaj/ditë):

___________________________

_______ / _________ / ________
(vite) (muaj) (ditë)

4. Dënime plotësuese nëse janë dhënë:

5. Periudha e e dënimit të ekzekutuar deri në datën e hartimit të dokumentit të lirimit

_______ / _________ / ________
(vite) (muaj) (ditë)

**I.4. Të dhënat e dokumentit të lirimit me kusht:**

1. Numri dhe data e kërkesës:

2. Të dhënat e punonjësit të shërbimit të provës:

Emri: ________________
Mbiemri: ________________
Institucioni: ________________

## II. BURIMET E INFORMACIONIT TË PËRDORURA PËR TË PËRGATITUR DOKUMENTIMIN E LIRIMIT ME KUSHT

*Përfshihen:* *personat e intervistuar; numri dhe data e intervistave të bëra me çdo person; dokumentet e konsultuara, si dhe të dhënat nëse ka patur burime informacioni për të cilat aksesi ka qenë i pamundur.*

______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________

## III. PËRSHKRIMI DHE ANALIZA E MËNYRËS SË EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT NGA I MITURI

*Përfshihen:* *sjellja e të miturit; nëse janë dhënë ndaj tij masa disiplinore; bashkëpunimi dhe sjellja me të miturit e tjerë të dënuar; sjellja e të miturit me personelin e institucionit; përfshirja*

edukuese/rehabilituese; pjesëmarrje në kurse profesionale; vazhdimi i programit të arsimimit; të menduarit kriminal, qëndrimi i të miturit ndaj veprës penale, ndaj viktimës dhe dëmeve të shkaktuara nga vepra penale.

## IV. PËRSHKRIMI DHE ANALIZA E TË MITURIT AUTORIT TË VEPRËS PENALE

*Përfshihen:* *kushtet e banimit; marrëdhënia dhe mbështetja nga familja; rrethi shoqëror; niveli i komunitetit ku jeton familja; arsimimi; formimi/trajnimi profesional; punësimi; gjendja fizike; emocionale; psikologjike dhe e shëndetit mendor; varësi të evidentuara nga subsatancat; stili i jetës; mënyra e të menduarit dhe rrethana të tjera me qëllim vlerësimin e rrezikut familjar/mjedisor jashtë ambientit të ekzekutimit të dënimit.*

## V. ANALIZA DHE VLERËSIMI I RREZIKUT

*Përfshihen:* *historiku kriminal; dënime të mëparshme (nëse ka); lloji i recidivizmit (i përgjithshëm/specifik); analiza e veprës penale; vlerësimi i rrezikut; mundësitë e përsëritjes së veprës penale ose të kryerjes së një vepre të re penale; qëndrimi ndaj veprës penale të kryer; niveli i motivimit; ecuria e bashkëpunimit me autoritet për t'iu nënshtuar programeve të edukimit, arsimimit, rehabilimit dhe riintegrimit; mendimet dhe pritshmëritë e riintegrimit pas lirimit.*

## VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

*Përfshihen: konkluzioni i analizës së rrethanave në lidhje me lirimin ose jo të të miturit me kusht; plani i ndërhyrjes për rehabilimit pas daljes nga institucioni, institucionet që duhet të përfshihen në realizimin me sukses të planit të rehabilimit.*

Nënshkrimi i punonjësit të shërbimit të provës që përgatiti dokumentin për lirimin me kusht

...............................................................

Drejtuesi i zyrës vendore (emri/mbiemri dhe nënshkrimi)

... .............................. ..............................................

*Vula e institucionit*